



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 225 Prot.

Tiranë, më 22/10/2014

V E N D I M

Nr. 156, Datë 22/10/2014

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në intervistën me titull "Ja pse jam antiverior e antimusliman", që gazetari [] ka marrë z. [] publikuar në gazetën Mapo-Weekend e datës 6-7 shtator 2014, bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: "Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji", nenin 46 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: "Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara", filloi procedimin administrativ kundër z. []. Në analizë të intervistës Komisioneri,

K O N S T A T O N :

Në intervistën me titull "Ja pse jam antiverior e antimusliman", që gazetari [] ka marrë z. [], publikuar në gazetën Mapo-Weekend e datës 6-7 shtator 2014, ka disa momente që bien ndesh me ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Pyetjes së gazetarit [] : "A jeni antigeg ju z. []?", z. [] i përgjigjet:

"Jam antiverior jo antigeg.Tani vijmë te Veriu. Fushë-Kruja, a e pe se si stafi i sigurisë i presidentit Bush i hoqi orën nga dora, nga frika se mos ia vidhnin fushëkrujasit? Laçi? Janë rrëzuar ose dëmtuar 36 shtylla të tensionit të lartë, si është e mundur? Vrasjet edhe ditën e zgjedhjeve të 23 Qershorit të kaluar? Bëj një listë sa kriminelë ka Laçi, Fushëkuqja, Lezha, Shëngjini, Rrësheni, Bajram Curri. etj. Shkodra kish 10 vrasje ne 6-mujorin e parë, asnjë në Korçë. Kriminelë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Sa nga Veriu ka në burgjet shqiptare dhe të huaja? Veriu është bërë tmerr i Europës.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Dukagjini kish mbjellë 115.000 rrënjë kanabis, gjuajti edhe policinë dhe dëmtoi helikopterin. Kukësi nuk paguan energjinë elektrike, e paguajmë ne për ta. Në Lurë kanë prerë gjithë pyllin. Tropoja ka mbi 150 vrasje, kanë vjedhur edhe një bankë në Angli.....”,

Ndërsa pyetjes: “Po antimusliman?”, z. ... i pergjigjet:

“Po jam antimusliman. Jam prej 500 vitesh.....Islami edhe sot është e vetmja fe e dhunës.Nga Afganistani në Libi....Islami edhe sot është e vetmja fe e dhunës.... Gjithë ajo hapësirë nuk gjen dot paqe dhe po tmerron botën. Xhihadistët kosovarë na kanë poshtëruar si asnjë tjetër me Skenderbeun monstër...Kanë 500 vjet që e urrejnë Heroin tonë....Ata urrejnë dhe fyejnë Nënë Terezën, që është shenjtorja jonë.....Islami më tremb se në mënyrë të papritur ka kthime mbrapsht në zona të errëta tmerri dhe mizorishë të padëgjuaara. Asnjëherë nuk i dihet se ç'sjell. Islami nuk të jep garanci. Unë dua dhe vlerësoj fetë paqësore. Kur islami të bëhet i tillë nuk do të jem më antimusliman”.

Komisioneri sa më sipër vlerëson:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bindjet fetare dhe vendbanimi, janë shkaqe për të cilat ligji ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe. Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Dinjteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij janë në bazat e shtetit shqiptar¹. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cenoje vetë ato, por edhe të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura

¹ Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë”



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

për të siguruar mos cënimin e tyre nga privatët. Pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për ti mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Në trajtimin e kësaj çështjeje Komisioneri, ka mbajtur parasysh që bëhet fjalë për dy të drejta themelore të njeriut, siç janë liria e besimit fetar dhe liria e shprehjes.

I.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14², garanton parimin e barazisë dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim, si dhe Protokollin Nr. 12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Barazia përpara ligjit është një parim kushtetues i sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë³. Në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë theksohet ndër të tjera se: *“Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, , për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare. me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor..... , për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit. Në nenin 24 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon lirinë e fesë: **“Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.”***

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, ndalon diskriminimin (çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë), që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, *pra edhe për shkak të vendbanimit apo besimit fetar* dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në bazë të nenit 3, pika 2 e ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, sanksionohet se ***një person apo***

² Neni 14, i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

³ Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“ Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”*



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

grup personash diskriminohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

2.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁴.

Duke mbajtur parasysh hierarkinë e normave juridike, të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, mbi epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen⁵. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkalar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. ***Në këtë aspekt edhe liria e shprehjes nuk mund të jetë absolute.*** Për këtë arsye, në analizën që i është bërë gjuhës së përdorur nga z.Velo, nëse ato do të konsideroheshin në tejkallim të lirisë së fjalës të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, i jemi referuar kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuara në nenin 10 të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. ***Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: "toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjithë qenieve njerëzore përbën bazat e një shoqërie demokratike pluraliste"***. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.

⁴ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: "Liria e shprehjes është e garantuar".

⁵ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: "Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut."



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Në intervistën në fjalë z. ... qëndrimin antiverior e justifikon me anë të disa "argumenteve" apo shifrave mbi rendin në këtë zonë dhe identifikon të gjithë individët që banojnë në këto zona si hajdutë apo kriminelë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Nga ana tjetër me anë të "argumenteve" të tij identifikon fenë myslimane si fe të dhunës, duke aluduar se të gjithë personat që i përkasin besimit mysliman karakterizohen nga këto cilësi.

Çdo individ ka të drejtën absolute për të patur mendimet e veta, por në kushtet kur këto mendime bëhen publike, liria e shprehjes, si një e drejtë themelore, nuk është absolute. Shoqëria karakterizohet nga shumëllojshmëri kulturash, besimesh fetare, stile jetese, zakonesh, si pasojë është e nevojshme që të pajtohen liria e shprehjes me të drejtat e tjera si lirisa e mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë dhe të drejtën për të mos u diskriminuar.

3.

Mbështetur në Rekomandimin 97(20) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, miratuar në 30 tetor 1997, "fjalimet e urrejtjes", përfshijnë të gjitha format e shprehjes të cilat shpërndajnë, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në mungesën e tolerancës.

Përshkrimet që z. ... i bën veriorëve në intervistë, duke i etiketuar si hajdutë e kriminelë dhe etiketimi i fesë myslimane si fe e dhunës, krijojnë ndjenja urrejtje, përbuzje duke sjellë ndarje, përçarje krahinore dhe fetare. Mjafton t'i referohemi debateve, komenteve dhe shkrimeve në rrjetet sociale apo shkrimeve në shtypin e shkruar apo online, të cilat intensifikojnë qëndrimet fyese dhe denigruese mbështetur në prejardhje krahinore apo besimin fetar.

Në çështjen Féret kundër Belgjikës, GJEDNJ ka bërë interpretime të rëndësishme, nga të cilat citojmë: "..... nxitja e urrejtjes nuk nënkupton domosdoshmërisht thirrje për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera nëpërmjet fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme....."⁶.

Komisioneri vlerëson se në çështjen në fjalë, përmbajtja e intervistës, është aq flagrante dhe përcjell një gjuhë të urrejtjes të pajustificuar, saqë edhe në mungesë të identifikimit të një individi konkret si viktimë diskriminimi, mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

⁶ Përkthim i Komisionerit



Gjykata Evropiane e Drejtësisë e ka theksuar këtë fakt në çështjen Feryn⁷ ku është shprehur se :”mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Direktivës për barazi bazuar në shkaqe raciale”⁸

Në çështjen Féret kundër Belgjikës⁹, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: “.....një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijohet mes publikut – e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirinformuar – ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje”¹⁰.

Duke iu rikthyer çështjes Féret kundër Belgjikës, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: “.....ndonëse deklaratat e ankuesit nuk drejtoheshin kundër individëve të caktuar – anëtarë të komuniteteve të emigrantëve/refugjatëve, ata i shihnin ata kolektivisht nën një dritë negative dhe i portretizonin si kontingjent krimi dhe oportunist të prirur për të përfutur nga rezidenca e tyre në Belgjikë”¹¹.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e Firmës Feryn, ka mbajtur qëndrimin dhe ka pramuar se diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet ankuesi. Për rrjedhojë, duke mos pasur nevojë për një viktimë, nuk lind nevoja as për të identifikuar një krahasues. Duke qenë se, paligjshmëria e sjelljes është aq flagrante, standarti të cilit Komisioneri i është referuar, është ai i një “standarti të vërtetë” që duhet të ekzistojë në një shoqëri demokratike, siç është “dinjiteti njerëzor”, pa qenë e nevojshme identifikimi i një krahasuesi, siç kërkohet nga pika 2, e nenit 3, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

4.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh edhe dy fakte të tjera të rëndësishme që janë, cilësia e zotit si person publik dhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur deklaratat.

Rëndësia që merr liria e fjalës për një person publik sjell dhe një përgjegjësi më të madhe, për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mos tolerancën dhe diskriminimin mes publikut. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Gjithashtu, **Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet shtypit të shkruar përbën një mjet të fuqishëm të përhapjes së informacionit.**

⁷ Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër Firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008

⁸ Përkthim i Komisionerit

⁹ Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009

¹⁰ Përkthim i Komisionerit

¹¹ Përkthim i Komisionerit



Në parimin 6, të Shtojcës së Rekomandimit Nr. (97) 20, theksohet se ligji dhe praktika kombëtare duhet të dallojë qartë përgjegjësinë e autorit të shprehjeve të gjuhës së urrejtjes në njërin anë dhe përgjegjësinë e medias dhe profesionistëve të medias, të cilët kontribuojnë në përhapjen, si pjesë e misionit të tyre për të komunikuar informacionin dhe idetë në çështjet e interesit publik, në anën tjetër. Por, në pjesën shpjeguese të rekomandimit theksohet se, kjo nuk do të thotë që mediat dhe profesionistët e medias nuk duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur kur publikojnë mbi gjuhën e urrejtjes ose mungesës së tolerancës në përgjithësi.

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës¹². E drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të *"fyejë, trondit apo shqetësojë"* të tjerët¹³.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 32, germa "c", si dhe nenit 33, pikat 10, 11 dhe 12 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

V E N D O S I :

- Përmbajtja e intervistës me titull *"Ja pse jam antiverior e antimusliman"*, që gazetari [...], si ka marrë z. [...], publikuar në gazetën Mapo-Weekend e datës 6-7 shtator 2014, është diskriminuese, sipas parashikimit të nenit 3, pika 2 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*.
- Detyrimin e z. [...], si personi i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të tërheqë publikisht deklaratat e bëra në intervistën e mësipërme, brenda 7 (shtatë) ditëve, nga marrja dijeni për këtë vendim, dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës që prodhon efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit.

¹² Çështja Erbakan kundër Turqisë, 6 korrik 2006, GJEDNJ- Përkthim i Komisionerit

¹³ Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, çështja nr. 5493/72, 07.12.1976 - Përkthim i Komisionerit



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

- Në zbatim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", detyrohet z. Maks Velo, që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
- Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikime të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

konc: "3.1.1" 

Irma BARAKU



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al